



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:205398

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747295

KPPP.nr.1553/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Oda e Avokatëve të Kosovës, me seli në Prishtinë, rruga “Bekim Fehmiu”, kundër debitorit Avokat Nasuf Hasani, me adresë në Prishtinë, rruga “Luan Haradinaj, Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.260/23 të datës 11.09.2023, të Përbaruesit Privat Isak Islami, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në çështjen përbarimore të kreditorit Oda e Avokatëve të Kosovës ndaj debitorit Avokat Nasuf Hasani, sipas prapësimit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.260/23 të datës 11.09.2023, të Përbaruesit Privat Isak Islami.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës KPPP.nr.1553/23, në çështjen përbarimore të kreditorit Oda e Avokatëve të Kosovës, kundër debitorit Avokat Nasuf Hasani, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës dhe gjeti se Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për

Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit lidhur me këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret çështja përmbartimore zhvillohet në mes të kreditorit si person juridik dhe debitorit si person fizik, me propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të përmbartueshëm, duke u bazuar në nenin 13 par.1 nën par. 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) me të cilin përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, dhe nën par. 1.2 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, pasi që në rastin konkret në cilësinë e kreditorit është personi juridik ndërsa në cilësinë e debitorit është personi fizik.

Ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykata dhe nenin 5 par. 5 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore i cili përcakton se *“ Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullësi në procedurën përmbartuese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbartuesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbartimi.”*, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore dhe nenin 13 par.1 nën par.1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.1553/23, datë 28.05.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.